

VENDIM
Nr.886, datë 22.12.2004

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR NË PROJEKTIN “ PLANIFIKIMI FAMILJAR III”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar në projektin “Planifikimi familjar III”, me një shumë financimi 1 000 000 (një milion) euro.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR 1996

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë,
në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;
duke u nisur nga dëshira për t’i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë;
të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj Marrëveshjeje;
me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë,
u morën vesh si vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë u jep mundësi Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe marrësve të tjerë që do të zgjidhen bashkërisht nga të dyja Palët Kontraktuese të marrin nga Kreditanstalt für Wiederaufbau, Frankfurt mbi Majn, një shumë financimi me vlefhtë prej gjithsej deri 1 000 000 euro (me fjalë: një milion euro) për projektin “Planifikimi familjar III”, kur nga shqyrtimi ka rezultuar se projekti vlen për t’u mbështetur dhe pasi u konfirmua se ai, duke qenë një projekt në fushën e infrastrukturës sociale, plotëson kushtet e posaçme për mbështetjen nëpërmjet një shume financimi.

2. Në qoftë se për projektin e përmendur në paragrafin I nuk mund të jepet konfirmimi i përmendur atje, atëherë Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Qeverisë së Republikës të Shqipërisë të marrë për këtë projekt nga Kreditanstalt für Wiederaufbau një hua deri në vlefthën e shumës së parashikuar të financimit.

3. Po të merren vesh Qeveria e Republikës të Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, projekti i përmendur në paragrafin 1 mund të zëvendësohet me projekte të tjera. Në qoftë se projekti i përmendur në paragrafin 1 do të zëvendësohet me një projekt, i cili plotëson kushtet e posaçme për mbështetjen nëpërmjet një shumë financimi, si projekt i mbrojtjes së mjedisit ose të infrastrukturës sociale, ose si fond garantues të kredive për ndërmarrje të mesme, ose si masë, e cila i shërben përmirësimit të pozitës shoqërore të grave, ose si masë, e cila synon luftimin e varfërisë, duke u mbështetur në parimin e vetëdihmës, atëherë mund të jepet një shumë financimi, përndryshe mund të jepet një hua.

Neni 2

1. Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratën që do të përfundohet ndërmjet Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe marrësit të shumës së financimit, kontratë e cila u nënshtrohet dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federate të Gjermanisë. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1 do të zhvleftësohet, në rast se kontrata përkatëse për financim nuk përfundohet brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premtimeve. Për shumën në fjalë, ky afat mbaron më datë 31 dhjetor 2004.

2. Qeveria e Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ajo vetë nuk është marrësja e shumës së financimit, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau pretendime eventuale lidhur me shlyerjen, që mund të lindin në bazë të kontratës për financim, e cila do të përfundohet sipas paragrafit 1.

Neni 3

Qeveria e Republikës së Shqipërisë e liron Kreditanstalt für Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratës së përmendur në nenin 2.

Neni 4

Qeveria e Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore që rezulton nga dhënia e shumës së financimit, nuk merr asnjë masë e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federate të Gjermanisë, dhe nxjerr në rastet e duhura lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën kur Qeveria e Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brenda shtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë, më 16 dhjetor 2004 në dy origjinalë, secili në gjuhën shqipe dhe atë gjermane, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë

Anastas Angjeli

Për Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë

Hans Peter Annen